

VENDIM
Nr. 596, datë 15.10.2025

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDITËSUAR TË MALLRAVE USHTARAKE
DHE TË LISTËS SË ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË
DYFISHTË, OBJEKT I KONTROLLIT SHETËTOR TË TRANSFERIMEVE
NDËRKOMBËTARE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, përkatësisht, sipas shtojcave I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

2. Vendimi nr. 511, datë 1.8.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Ky vendim përaftron plotësisht rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2024/2547, të datës 5 shtator 2024, që ndryshon rregulloren (BE) 2021/821 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, sa i përket listës së mallrave me përdorim të dyfishtë. Numri CELEX: CELEX:32024R2547; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian; seria L, nr. OJ L, 2024/2547, datë 7.11.2024 dhe “Listën e përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian”, të miratuar nga Këshilli, më 24 shkurt 2025 (pajisje të mbuluara nga qëndrimi i përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP, që përcakton rregulla të përbashkëta për kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake) (përditësim dhe zëvendësim i listës së përbashkët ushtarake të Bashkimit Evropian, të miratuar nga Këshilli më 19 shkurt 2024 (CFSP), numri CELEX 52025XG01499); Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian; seria C, nr. OJ, C/2025/1499, datë 6.3.2025.